



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

KONFIRMIM DEPOZITIMI DOKUMENTACIONI NË GJYKATË KUSHTETUESE

Në datë 23.09.2025, ora 11:28 u depozitua në Gjykatën Kushtetuese dokumentacioni me dërgues Jo më pak se 1/5 Deputetëve Av. Marash Logu dhe objekt:/lëndë:

Shtetëzimin shtetësit popullor shpallur me Kushtetutën e R. Sh.
nenit 2, Dekretit nr. 331 dt. 12.08.25 të Presidentit të Repub. e... etj

Përgjegjëse e protokoll-arkivit në Gjykatën Kushtetuese

Alketa Spahiu

Nënshkrimi (vula e sekretarisë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, më 23.09.2025

K Ë R K E S Ë

KËRKUES:

JO MË PAK SE 1/5 E DEPUTETËVE, përfaqësuar në gjykim nga Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Z. Gazment Bardhi dhe Av. Marash Logu, me adresë njoftimi: Kuvendi i Shqipërisë, Blv. Dëshmorët e Kombit Nr. 4, Tiranë, me email: marashlogual@gmail.com dhe nr.tel. +355674825149.

SUBJEKT

I INTERESUAR:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, me adresë njoftimi: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tiranë.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimin e nenit 2, të Dekretit “Për emërimin e Kryeministrit”, nr. 331, datë 12.09.2025, të Presidentit të Republikës së, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Shqipërisë.

2. Shfuqizimin e nenit 1, pika 1, fjalia e dytë, të Dekretit “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, nr. 333, datë 15.09.2025, të Presidentit të Republikës, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Shqipërisë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 7, 45, 92, 93, 95, 96, 98, 99, 102, 103, 131 dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë;

Nenet 49 dhe 50 të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të RSH”.

DREJTUAR:

**GJYKATËS KUSHTETUESE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

E Nderuar Znj. Kryetare,
Të Nderuar Gjyqtarë,

Në datën 12.09.2025, Presidenti i Republikës ka dekretuar emërimin e Kryeministrit, njëkohësisht duke përcaktuar edhe përgjegjësinë e tij “*për ngritjen dhe funksionimin e Ministrit Virtual të Inteligjencës Artificiale Diella*”. Po ashtu, në datën 15.09.2025, Presidenti i Republikës ka dekretuar përbërjen e Këshillit të Ministrave, duke përcaktuar njëkohësisht edhe përgjegjësinë e Kryeministrit “*për ngritjen dhe funksionimin e Ministrit Virtual të Inteligjencës Artificiale Diella*”. Duke qenë se vlerësojmë se neni 2, i Dekretit nr. 331, datë 12.09.2025 dhe neni 1, pika 1, fjalia e dytë, e Dekretit nr. 333, datë 15.09.2025, vijjnë në kundërshtim me nenet 7, 45, 93, 95, 96, 98, 99, 102 dhe 103 të Kushtetutës së Shqipërisë, po parashtrojmë këtë kërkesë me faktet, provat, të drejtën e aplikueshme, analizën ligjore dhe konkluzione, duke kërkuar paraprakisht shfuqizimin pjesërisht të dy dekreteve të sipërcituara.

I. RRETHANAT E CËSHTJES

1. Në datën 11.09.2025, gjatë Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste, kryeministri në detyrë Edi Rama gjatë prezantimit të përbërjes së qeverisë së tij të ardhshme, paraqiti edhe “emërimin” e një Ministri Virtual të Inteligjencës Artificiale Diella”, e cila do të kishte për detyrë të merrej me organizimin e procedurave të prokurimit publik. Sipas kryeministrit, “ministrja Diella” do të ishte një mekanizëm për të parandaluar

korruptionin dhe paligjshmëri të tjera, të cilat kanë rezultuar shumë problematike vitet e fundit, duke cuar pas hekurave një numër të konsiderueshëm të deputetëve, kryebashkiakëve, ministrave të Partisë Socialiste, të udhëhequr nga Edi Rama. Përfshirja e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë në procedurat e prokurimit publik ka qenë një propozim i bërë edhe më herët nga kryeministri, por i pa realizuar në praktikë.¹

2. Të nesërmen, në datën 12.09.2025, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste, Blendi Klosi, në cilësinë e partisë që ka shumicën e vendeve në Kuvendin e Shqipërisë, ka propozuar emërimin e Edi Ramës si Kryeministër. Në vijim të kësaj shkrese, me Dekretin “Për emërimin e Kryeministrit”, nr. 331, datë 12.09.2025, Presidenti i Republikës ka dekretuar: *“Zoti Edi Rama emërohet Kryeministër i Republikës së Shqipërisë (shih nenin 1). Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e Ministrisë Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella” (shih nenin 2). Ky dekret hyn në fuqi menjëherë (shih nenin 3).”*. [Prova nr. 1 – Dekreti nr. 331, datë 12.09.2025 i Presidentit të Republikës së Shqipërisë]

3. Pas paraqitjes së propozimeve nga Kryeministri, me Dekretin “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, nr. 333, datë 15.09.2025, Presidenti i Republikës ka dekretuar: *“Emërimin e Këshillit të Ministrave me këtë përbërje: 1. Edi Rama – Kryeministër; Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e Ministrisë Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella” (shih nenin 1). Ky dekret hyn në fuqi menjëherë (shih nenin 2).”*. [Prova nr. 2 – Dekreti nr. 333, datë 15.09.2025 i Presidentit të Republikës së Shqipërisë] Në faqen zyrtare të Këshillit të Ministrave, nën rubrikën “Qeveria”, gjendet përbërja e plotë e Këshillit të Ministrave, ku pas Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministres, është “Ministër Shteti për Inteligjencës Artificiale Diella”, e cila sipas përshkrimit lindi më 19 janar 2025 dhe deri në shtator 2025 ishte Asistente Virtuale e platformës kombëtare e-albania, dhe nga shtatori 2025 e në vijim është Ministër Shteti për Inteligjencës Artificiale.²

¹ <https://ps.al/newsroom/mbahet-asambleja-kombetare-e-ps-kryetari-rama-prezanton-ekipin-e-katert-qeverises/>

² <https://kryeministria.al/ministrat/diella/>

II. E DREJTA E APLIKUESHME

4. Kushtetuta e Shqipërisë:

- (i) **Neni 7** parashikon: *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.”.*
- (ii) **Neni 45** parashikon: *“Cdo shtetas shqiptar që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. 2. Përfshihen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht. 3. Përfshihen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cënim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.”.*
- (iii) **Neni 92** parashikon: *“Presidenti ushtron edhe këto kompetenca: a) i drejton mesazhe Kuvendit; b) ushtron të drejtën e faljes sipas ligjit; c) jep shtetësinë shqiptare dhe lejon lënien e saj; ç) jep dekorata e tituj nderi sipas ligjit; d) jep gradat më të larta ushtarake sipas ligjit; dh) me propozim të Kryeministrit, emëron dhe liron përfaqësuesit e plotfuqishëm të Republikës së Shqipërisë në shtetet e tjera dhe në organizatat ndërkombëtare; e) pranon letrat kredenciale dhe tërheqjen e përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e*

Shqipërisë; ë) lidh marrëveshje ndërkombëtare sipas ligjit; f) me propozim të Kryeministrit, emëron drejtorin e shërbimit informative të shtetit; g) emëron Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit; gj) cakton datën e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve; h) kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.”.

- (iv) **Neni 93** parashikon: “*Presidenti i Republikës, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr dekrete.”.*
- (v) **Neni 95** parashikon: “*1. Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat. 2. Këshilli i Ministrave ushtron cdo funksion shtetëror, i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.”.*
- (vi) **Neni 96** parashikon: “*1. Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.”.*
- (vii) **Neni 97** parashikon: “*Kryeministri i emëruar sipas nenit 96, nenit 104 ose 105, i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij.”.*
- (viii) **Neni 98** parashikon: “*1. Ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Kryeministrit, brenda 7 ditëve. 2. Dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi.”.*

- (ix) **Neni 99** parashikon: *“Para fillimit të detyrës, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës.”*.
- (x) **Neni 100** parashikon: *“1. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. 2. Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës. 3. Mbledhjet e Këshillit të Ministrave bëhen të mbyllura. 4. Aktet e Këshillit të Ministrave janë të vlefshme, kur nënshkruhen nga Kryeministri dhe ministri propozues. 5. Këshilli i Ministrave nxjerr vendime dhe udhëzime.”*.
- (xi) **Neni 102** parashikon: *“1. Kryeministri: a) përfaqëson Këshillin e Ministrave dhe kryeson mbledhjet e tij; b) koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për to; c) siguron zbatimin e legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli i Ministrave; ç) bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera të administratës qendrore të shtetit; d) kryen detyra të tjera të parashikuara në Kushtetutë e në ligje. 2. Kryeministri zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave. 3. Kryeministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra. 4. Ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton në përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë. Ministri, në zbatim të kompetencave të tij, nxjerr urdhra dhe udhëzime.”*.
- (xii) **Neni 103** parashikon: *“1. Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet. 2. Ministri nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore dhe as të jetë drejtues ose anëtar i organeve të shoqërive fitimprurëse. 3. Anëtarët e Këshillit të Ministrave gëzojnë imunitetin e deputetit.”*.

- (xii) **Neni 131** parashikon: “Gjykata Kushtetuese vendos për: c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;”.
- (xiii) **Neni 134** parashikon: “1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: c) jo më pak se një të pestës së deputetëve.”.

5. Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”:

- (i) **Neni 49** parashikon: “1. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit.”.
- (ii) **Neni 50** parashikon: “1. Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të nenit 49, të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.”.

III. ANALIZA LIGJORE

A. Lidhur me legjitimimin e kërkesit

A.1 Për legjitimimin *ratione personae*

6. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar listën e çështjeve, shqyrtimi i të cilave është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese. Ndër të tjera, në nenin 131, gërma “c”, përcaktohet se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet

ndërkombëtare. Nga interpretimi i kësaj dispozite del qartë se pretendimet për pajtueshmëri me Kushtetutën apo marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria bën pjesë të akteve normative që prodhojnë organet qendrore apo vendore mund të ngrihen dhe të shqyrtohen vetëm nga Gjykata Kushtetuese. Kjo dispozitë pasqyron qartë një prej kompetencave thelbësore të Gjykatës Kushtetuese për të garantuar që veprimtaria e organeve publike, e mishëruar nëpërmjet akteve të tyre, të jetë në përputhje dhe në respekt të Kushtetutës.

7. Ndërsa, në nenin 134, të Kushtetutës, gjejmë të përcaktuar listën e subjekteve që kanë të drejtë të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues. Këto subjekte ndahen në dy kategori. Të parat ku përfshihen Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit konsiderohen si subjekte të pakushtëzuara, pasi ato mund ta investojnë Gjykatën, pa pasur nevojë të provojnë interesin e tyre konkret në çështjen objekt shqyrtimi. Ndërsa, kategoria e dytë ku përfshihen Kryetari i KLSH-së, gjykatat, komisionerët e krijuar me ligj, KLGJ-ja dhe KLP-ja, organet e qeverisjes vendore, bashkësitë fetare, partitë politike, organizatat dhe individët, duhet të provojnë interesin e tyre konkret në çështjet objekt shqyrtimi, në mënyrë që të legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës.

8. Këto dispozita i gjejmë të reflektuara edhe në Ligjin organik nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” (në vijim “Ligji nr. 8577/2000”), përkatësisht në nenin 49 të tij. Konkretisht, neni 49 përcakton se të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit. Kjo dispozitë përmban në vetvete elementë të të përcaktimeve kushtetuese sa i përket kompetencës së Gjykatës Kushtetuese, por edhe të drejtës së pakushtëzuar të jo më pak se 1/5 së deputetëve të Kuvendit për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues.

9. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të shfuqizuar pjesërisht Dekretin nr. 331, datë 12.09.2025 dhe Dekretin nr. 333, datë 15.09.2025, të Presidentit të Republikës. Dispozitat e kundërshtuara nëpërmjet kësaj kërkeje në përmbajtje të këtyre dekreteve përbëjnë akte normative, pasi ato përcaktojnë një strukturë të re shtetërore (ministri virtuale) dhe një përgjegjësi të re qeverisëse për Kryeministrin (ngritjen dhe funksionimin e ministrisë virtuale). Një akt juridik që përcakton krijimin e një strukture të re ministrore, pra një organi të ri kushtetues, sic është ministri/ministria, si dhe shton një kompetencë/përgjegjësi të re të Kryeministrit nuk mund të konsiderohet akt individual apo kolektiv, por është qartazi një akt normativ, që imponon rregulla të detyrueshme sjellje dhe nuk shtron në zbatimin e tij.

10. Lidhur me natyrën juridike të dekreteve presidenciale, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“Nga përmbajtja dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del qartë se Presidenti i Republikës si kryetar i shtetit edhe pse është i ndarë nga organet kryesore që realizojnë pushtetet, kryen disa funksione që kanë natyrën e këtyre pushteteve. Është kjo arsyeja që Presidenti i Republikës në ushtrimin e funksioneve të tij, krahas akteve që janë rezultat dhe shprehje e drejtimit politik, nxjerr akte individuale me karakter administrativ. Në aktet me karakter administrativ përfshihen edhe Dekretet për shkarkimin nga detyra të prokurorëve si masë me karakter disiplinor. Duke pasur të tilla cilësi, Dekreti, në bazë të dispozitave kushtetuese të përmendura më lart dhe në harmoni me frymën e përmbajtjen e legjislacionit e të praktikës së mirëfilltë gjyqësore, duhet të jetë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor.”* (shih vendimin nr. 25, datë 13.02.2002; nr. 38, datë 23.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Ndërsa, Gjykata Kushtetuese e Kosovës është shprehur se dekretet sipas përmbajtjes së tyre ndahen në dy kategori. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë dekretet me karakter normativ, me efekt ndaj organeve shtetërore, siç janë dekretet për caktimin e datës

së zgjedhjeve parlamentare dhe lokale, për caktimin e mandatarit për formimin e Qeverisë, etj. Karakterin normativ të dekreteve presidenciale të kësaj natyre ia përcakton rëndësia e marrëdhënies juridike që ai rregullon, gjegjësisht të drejtat dhe detyrimet që ai përcakton për organet e ndryshme shtetërore. Në të tilla raste norma urdhëruese e dekretit është normë kushtetuese dhe për rrjedhojë i nënshtrohet vetëm kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese (shih Aktgjykimin nr. KO72/20; nr. KI214/21 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës).

12. Nga sa më lart del që kompetenca e Presidentit si ato të ushtruara nëpërmjet nenit 2, të Dekretit nr. 331/2025 dhe nenit 1, pika 1, fjalia e dytë, të Dekretit nr. 333/2025, sic do të trajtojmë në vijim, nuk është e parashikuar as në Kushtetutë dhe as në ligj, duke krijuar një normë tërësisht të re që i imponohet Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, qoftë në drejtim të krijimit të një strukture të re ministrore, ashtu edhe të përgjesisë që ka Kryeministri për ngritjen dhe funksionimin e kësaj strukture. Përveçse Presidenti ka vepruar në tejkalim të kompetencave të tij, ai ka vepruar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që rregullojnë cilësitë që duhet të ketë personi që emërohet ministër. Prandaj, shqyrtimi i kësaj kërkesë është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në zbatim të nenit 131, gërma “c”, të Kushtetutës, ashtu si edhe subjekti jo më pak se një e pesta e deputetëve të Kuvendit bën pjesë në kategorinë e subjekteve të pakushtëzuara që mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues, në zbatim të nenit 134, pika 1, gërma “c”, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 8577/2000. Në këtë kuptim, kërkuesi gëzon *legitimitio personae*.

A.2 *Për legjitimimin ratione temporis*

13. Përveçse çështja objekt shqyrtimi duhet të jetë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131, të Kushtetutës, dhe kërkuesi duhet të gëzojë legjitimimin personal në kuptim të nenit 134, të Kushtetutës, një kusht tjetër thelbësor që duhet të plotësojë një kërkesë për t’u pranuar për shqyrtim është respektimi i afatit. Në

rastin e kontrollit kushtetues të akteve normative, afatin e gjejmë të përcaktuar në nenin 50, pika 1, të Ligjit nr. 8577/2000. Sipas kësaj dispozite afati për paraqitjen e një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese është dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të aktit. Në rastin konkret, Dekreti nr. 331 i Presidentit të Republikës është miratuar në datën 12.09.2025, ndërsa Dekreti nr. 333 i Presidentit të Republikës është miratuar në datën 15.09.2025, duke hyrë në fuqi menjëherë, çka do të thotë se kjo kërkesë po paraqitet brenda afatit ligjor. Në këtë kuptim, kërkuesi gëzon *legitimatio temporis* për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. *Lidhur me tejkalimin e kompetencave kushtetuese nga Presidenti i Republikës*

14. Kushtetuta e Shqipërisë përcakton se Presidenti i Republikës është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit (shih nenin 86). Në këtë cilësi, kushtetutbërësi ka renditur në një listë disa prej kompetencave të Presidentit të Republikës që lidhen me mesazhet drejtuar Kuvendit, të drejtëne faljes sipas ligjit, dhënien e shtetësisë, dhënien e garadave ushtarake, emërimin e përfaqësuesve diplomatikë, lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, emërimin e drejtorit të shërbimit informativ, Kryetarit të Akademisë së Shkencave, rektorëve të universiteteve, caktimit të datës së zgjedhjeve, referendumeve, si dhe marrjen e mendimeve apo të dhënave nga drejtuesit e institucioneve (shih nenin 92). Përveç këtyre kompetencave, kushtetutbërësi i ka dhënë kompetencë Presidentit të Republikës, që me propozim të partisë që ka shumicën e vendeve në Kuvend, të emërojë Kryeministrin në fillim të legjislaturës (shih nenin 96), si dhe me propozim të Kryeministrit të emërojë ministrat (shih nenin 98). Për këtë qëllim, Presidenti shprehet me dekrete (shih nenin 93). Në çdo rast, emërimin e Presidentit të Republikës i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendi. Pas marrjes së këtij miratimi, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat betohen para Presidentit të Republikës (shih nenin 99).

15. Ndërkohë që duke u ndalur te Këshilli i Ministrave, kushtetutbërësi ka përcaktuar se Këshilli i Ministrave përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe

ministrat (shih nenin 95). Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Për realizimin e kësaj kompetence, Këshilli i Ministrave merr vendime me propozim të Kryeministrit ose të ministrit përkatës. Këshilli i Ministrave shprehet me vendime dhe udhëzime (shih nenin 100). Figurë kryesore në Këshillin e Ministrave mbetet Kryeministri, për të cilin kushtetutbërësi ka përcaktuar listën e kompetencave të tij, përkatësisht përfaqësimin e Këshillit të Ministrave, kryesimin e mbledhjeve, konceptimin dhe paraqitjen e drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, sigurimin e zbatimit të legjislacionit dhe të politikave të miratuara nga Këshilli, bashkërendimin e punës së ministrave dhe institucioneve të varësisë, zgjidhjen e mosmarrëveshjen ndërmjet ministrave, nxjerrjen e urdhërave etj. Ndërsa, sa i përket ministrit, kushtetutbërësi ka përcaktuar se ai drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë, duke nxjerr urdhra dhe udhëzime (shih nenin 102).

16. Megjithëse, Presidenti i Republikës nuk bën pjesë në skemën klasike të pushteteve (legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor), kompetencat dhe përgjegjësitë që ai ka në strukturën shtetërore bëjnë që të përfaqësojë një pushtet të veçantë, i cili i nënshtrohet detyrimeve që ka çdo pushtet për të respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Kjo nënkupton që Presidenti, nga njëra ka të drejtë të mbrojë kompetencat që atij i jep Kushtetuta dhe ligji, duke pasur nga ana tjetër detyrimin për të respektuar kompetencat dhe përgjegjësitë e pushteteve apo institucioneve të tjera shtetërore. Në këtë kuptim, Presidenti nuk mund t'i lejojë vetes të ndërhyjë në kompetencat e Kuvendit, Këshillit të Ministrave apo sistemit të drejtësisë (prokurorisë, gjykatave, organeve qeverisëse të sistemit KLGJ/KLP). Një ndërhyrje e tillë do të ishte në kundërshtim me nenin 7, të Kushtetutës së Shqipërisë, që sanksionon ndarjen dhe balancimin e pushteteve.

17. Duke u kthyer në rastin konkret, rezulton se Presidenti i Republikës, nëpërmjet Dekreteve nr. 331, datë 12.09.2025 dhe nr. 333, datë 15.09.2025, ka përcaktuar ndër të tjera edhe *“Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e Ministrit Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella”*” (shih nenin 2, të Dekretit nr.

331/2025; shih nenin 1, pika 1, fjalë e dytë, të Dekretit nr. 333/2025). Nëpërmjet këtyre dispozitave, Presidenti ka krijuar praktikisht një strukturë të re ministrore (ministri virtuale), si dhe ka ngarkuar Kryeministrin me një përgjegjësinë të re për ngritjen dhe funksionimin e ministres virtuale “Diella”. Pyetjet që shtrohen në këtë rast është nëse Presidenti i Republikës ka kompetencë të krijojë strukturë të re ministrore dhe t’i caktojë Kryeministrit përgjegjësi të reja. Në vijim do të trajtojmë secilën prej këtyre pyetjeve, nën dritën e dispozitave kushtetuese të sipërcituara sa i përket Presidentit të Republikës, ashtu edhe Këshillit të Ministrave.

18. Duke u ndalur te pyetja nëse Presidenti ka kompetencë të krijojë një strukturë të re ministrore, në fakt në asnjë prej dispozitave që rregullojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e Presidentit të Republikës nuk gjejmë një kompetencë të tillë në mënyrë direkte apo të nënkuptuar. Neni 96, pika 1, i jep të drejtë Presidentit vetëm të emërojë Kryeministrin, me propozim të partisë që ka shumicën parlamentare, ndërsa neni 98, pika 1, i jep të drejtë vetëm të emërojë ministrat me propozim të Kryeministrit. Nuk ekziston pra asnjë kompetencë apo e drejtë e Presidentit për të krijuar një strukturë të re ministrore, qoftë reale apo virtuale. Madje duke vepruar kështu, Presidenti ndërhyr në kompetencën që ka Kryeministri për të propozuar përbërjen e qeverisë (shih nenin 96, pika 1), si dhe kompetencën që ka Këshilli i Ministrave për të përcaktuar drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore (shih nenin 100, pika 1). Në këtë kuptim, krijimi i një “ministri” virtual apo real nga Presidenti i Republikës është në tejkalim të kompetencave të Presidentit të Republikës, çënon kompetencat e Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave, duke shkelur kështu parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës së Shqipërisë.

19. Lidhur me pyetjen e dytë nëse Presidenti ka kompetencë t’i caktojë Kryeministri përgjegjësi të reja, si përgjësia “*për ngritjen dhe funksionimin e Ministrisë Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella”*”, sërisht në përmbajtje të dispozitave kushtetuese që rregullojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e Presidentit të Republikës nuk

gjendet një kompetencë e tillë në mënyrë direkte apo të nënkuptuar. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryeministrit janë të rregulluar nga Kushtetuta (shih nenin 102) dhe ligje të veçanta. Presidenti i Republikës ka vetëm detyrën e emërimit të Kryeministrit, sipas propozimit të partisë që ka shumicën parlamentare (shih nenin 96, pika 1), si dhe emërimin e përbërjes së qeverisë (zëvendëskryeministri, ministrat), sipas propozimit të Kryeministrit (shih nenin 98, pika 1). Madje, caktimi i përgjegjësive të reja nga Presidenti për Kryeministrin vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet, si dhe cënon edhe pushtetin legjislativ (Kuvendin), duke qenë ky i fundit i vetmi organ që ka të drejtën të miratojë ndryshime kushtetuese apo ligjore, të cilat shtojnë, pakësojnë, ndryshojnë përgjegjësitë dhe kompetencat e Kryeministrit. Në këtë kuptim, caktimi i përgjegjësive të reja të Kryeministrit, përveçse vjen në kundërshtim me kompetencat kushtetuese të Presidentit, cënon edhe kompetencat e pushtetit legjislativ, duke shkelur parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës.

20. Pasur parasysh sa më sipër del qartë se neni 2, i Dekretit nr. 331, datë 12.09.2025, ashtu si edhe neni 1, pika 1, fjalia e dytë “Kryeministri ushtron edhe përgjegjësitë për ngritjen dhe funksionimin e Ministrit Virtual të Inteligjencës Artificiale “Diella””, janë në tejkalim të kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës, si dhe cënojnë kompetencat e pushtetit ekzekutiv (Kryeministrit/Këshillit të Ministrave), ashtu edhe të pushtetit legjislativ (Kuvendit), qoftë në drejtim të krijimit të një strukture të re ministrore, ashtu edhe në drejtim të caktimit të përgjegjësive të reja të Kryeministrit. Për rrjedhojë, këto dispozita duhen kundërshtuar si të papajtueshme me nenet 92, 93, 96, 98, 100, 102 dhe 7 të Kushtetutës së Shqipërisë. Cdo interpretim i kundërt, do t’i jepte Presidentit të Republikës mesazhin e gabuar se nga një figurë neutrale me kompetenca kryesisht të karakterit ceremonial dhe protokollar, nëpërmjet përdorimit politik të dekreteve presidenciale, ai mund të shndërrohet në një aktor të politikave shtetërore, duke krijuar rishtazi “ministri” dhe caktuar përgjegjësi të reja kryeministore.

C. *Lidhur me krijimin e një “ministri/e virtuale” në kundërshtim me Kushtetutën*

21. Kushtetuta e Shqipërisë ka përcaktuar përbërjen e Këshillit të Ministrave, përkatësisht Kryeministrin, zëvendëskryeministrin dhe ministrat (shih nenin 95). Duke u ndaluar të ministri, Kushtetuta përcakton se ministri emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Kryeministrit (neni 98). Ministër mund të caktohet kushdo që ka cilësitë për deputet (shih nenin 103). Këto cilësi i gjejmë në nenin 45, të Kushtetutës, e cila përcakton cilësitë e deputetit, përkatësisht i) shtetasi shqiptar; ii) që ka mbushur moshën 18 vjeç; iii) është i aftë mendërisht; dhe iv) nuk i ndalohej kandidimi/emërimi sipas legjislacionit të dekriminalizimit (shih nenin 45). Para fillimit të detyrës, ministri betohet para Presidentit të Republikës (shih nenin 99). Ndërsa, sa i përket kompetencave të tij, kushtetutbërësi është shprehur se ministri, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, drejton nën përgjegjësinë e tij veprimtarinë që ka në kompetencë, nëpërmjet nxjerrjes së urdhrave dhe udhëzimeve (shih nenin 102, pika 4). Pra, Kushtetuta e Shqipërisë ka ofruar një panoramë të qartë të cilësive që duhet të ketë ministri, procedurës së emërimit të tij, si dhe kompetencave dhe përgjegjësi.

22. Pyetja që shtrohet në këtë rast është nëse “Ministri Virtual i Inteligjencës Artificiale “Diella””, që rezulton në përmbajtje të nenit 2, të Dekretit nr. 331, datë 12.09.2025, dhe nenit 1, pika 1, fjalë e dytë, të Dekretit nr. 333, datë 15.09.2025, të Presidentit të Republikës, përmbush cilësitë e nevojshme të të qënurit ministër, procedurën e emërimit, ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi. Në fakt, është e qartë se një “ministër virtual” nuk përmbush asnjërën prej cilësive të ministrit që janë renditur më lart, përkatësisht të qënurit i) shtetas shqiptar; ii) që ka mbushur moshën 18-vjeç; iii) i aftë mendërisht; dhe iv) i padënuar sipas ligjit të dekriminalizimit. Po ashtu, “ministri virtual” nuk rezulton që të jetë propozuar nga Kryeministri siç kemi trajtuar më lart, apo që të ketë kryer betimin para Presidentit të Republikës. Shtuar këtu faktin që “ministri virtual” duke qenë thjesht një produkt i teknologjisë së informacionit nuk ushtron nën përgjegjësi

personale kompetencat që ka dikasteri që drejton. Në këtë kuptim, është e qartë se koncepti “Ministri Virtual i Inteligjencës Artificiale “Diella””, vjen në kundërshtim me Kushtetutën, qoftë në drejtim të cilësive të kërkuara të të qënurit ministër, procedurës së emërimit të tij, betimit para Presidentit të Republikës, si dhe ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi.

23. Pasur parasysh sa më sipër, është e qartë se qoftë edhe në këtë drejtim neni 2, i Dekretit nr. 331/2025 dhe neni 1, pika 1, fjalia e dytë, e Dekretit nr. 333/2025, të Presidentit të Republikës janë në kundërshtim me nenet 95, 98, 103, 45, 99 dhe 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, e si të tilla duhen shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën e Shqipërisë. Por, ndërkohë që Kushtetuta është shumë e qartë në këtë drejtim, ajo çka është e papranueshme në këtë rast është përfshirja e Presidentit të Republikës, që supozohet të jetë gardiani i Kushtetutës, në një veprimtari të tillë që përveçse shkel rëndë Kushtetutën, dëmton edhe seriozitetin dhe reputacionin e shtetit shqiptar. Kreu i shtetit dhe përfaqësuesi i unitetit të popullit duhet të ishte në krye të përpjekjeve për të garantuar ruajtjen e standardeve më të larta kushtetuese, promovimin e ruajtjes së pavarësisë së pushteteve, nxitjen e mirëfunksionimit të institucioneve demokratike dhe përmirësimin e imazhit të shtetit shqiptar dhe institucioneve të tij. Ta shndërrosh shtetin dhe aktet juridike të Presidentit të Republikës në qesharake është krejtësisht e papranueshme dhe për turpin e kujtdo që merr përsipër autorësinë e akteve të tilla.

IV. KONKLUZIONE

24. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në kushtet kur neni 2, Dekreti “Për emërimin e Kryeministrit”, nr. 331, datë 12.09.2025, dhe neni 1, pika 1, fjalia e dytë, e Dekretit “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, të Presidentit të Republikës:

- (i) Cënojnë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, pasi Presidenti krijon një strukturë të re ministrore (ministrit virtual të inteligjencës artificiale), dhe i cakton Kryeministrit përgjegjësi të reja (për ngritjen dhe funksionimin e ministrit virtual);

- (ii) Cënojnë organin kushtetues të ministrit, pasi Presidenti krijon një “ministër virtual”, i cili nuk përmbush cilësitë kushtetuese të emërimit si ministër, procedurat e emërimit dhe betimit të tij, si dhe ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi;
- (iii) Shkelin në mënyrë flagrante nenet 7, 45, 92, 93, 95, 96, 98, 99, 102 dhe 103 të Kushtetutës së Shqipërisë, që lidhen me kompetencat e Presidentit të Republikës, kompetencat e Kryeministrit/Këshillit të Ministrave, cilësitë e ministrit, procedurën e emërimit dhe betimit të tij, ushtrimin e kompetencave ministrore;

në mbështetje të neneve 131 dhe 134 të Kushtetutës së Shqipërisë, neneve 49 dhe 50, të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, *përfundimisht*,

KËRKOJMË:

- (i) Shfuqizimin e nenit 2, të Dekretit “Për emërimin e Kryeministrit”, nr. 331, datë 12.09.2025, të Presidentit të Republikës së, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Shqipërisë.
- (ii) Shfuqizimin e nenit 1, pika 1, fjalia e dytë, të Dekretit “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, nr. 333, datë 15.09.2025, të Presidentit të Republikës, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Shqipërisë.

- Bashkëlidhur gjeni provat:

- (i) Prova nr. 1 – Dekreti “Për emërimin e Kryeministrit”, nr. 331, datë 12.09.2025 i Presidentit të Republikës;
- (ii) Prova nr. 2 – Dekreti “Për emërimin e Këshillit të Ministrave”, nr. 333, datë 15.09.2025 i Presidentit të Republikës.

Me konsideratë,

D E P U T E T Ë T

1- Gremont Berthe ~~Berthe~~

2- Ina Zkupa ~~Thy~~

3- Oerd Sylykshut (Grim)

4- Kleva Bollin ~~Ilen~~

5- Blodan Melbente

6- Kastriot Iroli Iroli 2025

7/10 Am Shuh TH

8) Klit Heth pot

9) Greta Zendele S

10) Gent Straximi ~~Gen~~

11) Albene Vobshi ~~Alb~~

12- ISUP ERAS ~~atpalef.~~

13. Jangle Tedsen

14 Kidal Kreta ~~15~~

15. Ledimas Atolli ~~16~~

16. Kamchen Liko ~~17~~

17. Floummy / Heste ~~18~~

18. Lucaraxo Bogi ~~19~~

19. ... ~~20~~

- 20 - Ajron Gekmarky 247
- 21 - Elda Hoti CH
- 22 - DESART XHAFERI
- 23 - BELIND KENIÇI Belind Kulu
- 24 - Xhela Marin genc
- 25 - Juan Baci genc
- 26 - Ena Boti genc
- 27 - Tomor Ali 201
- 28 - Shkur Qedini genc
- 29 - Arben Lika genc
- 30 - Ivi Koso genc
- 31 - plendi Himgi genc
- 32 - Arman Abaz genc
- 33 - Firdiana Laga genc
- 34 - Zija Ismaili genc
- 35 - Demisa Vota genc
36. Zina Zina genc
37. Tedi Blushi genc
38. ERISA XHIXHO genc
39. Brunilda Haxhi genc